

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**DEPATAMENTI I GJUHËS SHQIPE**



**PUNIM DIPLOME**

**ÇËSHTJE TË DYGJUHËSISË NË DIASPOREN SHQIPTARE**

**Mentori:**

**Prof. ass. dr. Fridrik DULAJ**

**Studentja:**

**Fillojeta SALIHU**

**Gjakovë, 2017**

## **PËRMBAJTJA**

Qëllimi.....	4
Pyetje hulumtuese.....	4
Hipoteza .....	4
Metodologjia .....	4
Hyrja.....	5

## **KAPITULLI I PARË**

### **Çështje të dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë (shqyrtim teorik)**

1. Dygjuhësia ose bilinguizmi.....	6
2. Shumëgjuhësia ose multilinguizmi.....	6
3. Dallimi bilinguizëm- plurilinguizëm- multilinguizëm.....	7
4. Dallimi dygjuhësi- diglosi.....	7
5. Shkaqet e kontakteve mes gjuhëve dhe lingua franca.....	8-9
6. Dygjuhësia e emigracionit dhe faktorët socialë.....	9
7. Dygjuhësia tek te folmet e arbëreshëve të Italisë.....	10
8. Përzirja e kodeve gjuhësore.....	10-11

## **KAPITULLI I DYTË**

### **1. Ndikimi fonetik i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë**

1.1 Theksi .....	12
------------------	----

### **2. Ndikimi morfologjik i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë**

1.1 Emri.....	13
1.2 Mbiemri.....	13
1.3 Përemri.....	14
1.4 Parafjala.....	15

### **3. Ndikimi sintaksor i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë**

1.1 Rendi i fjalisë.....	16
--------------------------	----

1.2 Fjalë dëftore.....	16
1.3 Fjalë pyetëse.....	16-17
1.4 Fjalë dëshirore.....	17
<b>4. Përbërja leksikore e dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë.....</b>	<b>18</b>
Materiale.....	19
Përfundimi.....	20
Literatura.....	21

## Qëllimi

Qëllimi kryesor i hartimit të këtij punimi është *studimi i çështjeve të dygjuhësisë tek te folmet e bashkëatdhetarëve tanë që jetojnë në diasporë*, përkatësisht në Amerikë, Zvicër, Gjermani e Angli.

## Pyetje hulumtuese:

- a) *Cilat janë shkaqet e shfaqjes së dygjuhësisë te shqiptarët e diasporës?*
- b) *Tek cilat mosha është më e përhapur dygjuhësia?*
- c) *Në cilat fusha të gjuhës shfaqen dallimet më kryesore?*
- d) *Çka ndikon në shfaqjen e dygjuhësisë tek fëmijët?*

## Hipoteza

Pas përfundimit të hulumtimeve tona kemi parë se *çështja e dygjuhësisë është mjaft e përhapur* në diasporën ku jetojnë bashkëatdhetarët tanë, si tek fëmijët ashtu edhe tek te rriturit.

## Metodologjia

Për të pasqyruar atë çfarë kërkon ky punim është përdorur *metoda e intervistimit të personave që jetojnë në situata dygjuhësie*. Intervistimi është bërë në mënyrë *të qëllimshme* mirëpo duke mos u treguar arsyeën e vërtetë, *në mënyrë spontane* apo vetëm *duke dëgjuar atë se çfarë thonë ata*, për arsye që mbledhja e materialit të bëhet sa më natyrshëm.

Materiali i mbledhur gjatë intervistimit është shfrytëzuar si shembull, ndërsa për shpjegim teorik është shfrytëzuar literatura nga studiuesit e mëparshëm të kësaj fushe.

## HYRJA

Tema e cila është trajtuar në këtë punim i takon rrafshit të *sociolinguistikës*.

Faktorët ekonomik, social si dhe bashkëjetesa në situata dygjuhësie e shqiptarëve të diasporës padyshim që kushtëzon edhe ndikimin *ndërgjuhësor* të tyre. Të lidhur ngushtë me vendin ku punojnë e jetojnë, natyrisht rrjedh edhe *ndikimi i gjuhës së bukës mbi gjuhën e zemrës*, prandaj gjatë hulumtimeve për këtë punim na dalin shumë elemente si te gjuhës gjermane ashtu edhe te gjuhës angleze.

Ndikimi i gjuhës angleze mbi gjuhës shqipe shtrihen në disa rrafshet gjuhësore siç janë: *rrafshi fonetik, morfologjik, sintaksor e leksikor*, kurse ndikimi i gjuhës gjermane është më i përhapur kryesisht në *rrafshin e leksikut*.

Statusi gjuhësor, natyrisht është ai i shumicës së diasporës shqiptare: shqipja si gjuhë e vatrës, me përdorim kryesisht në familje dhe në mjedis shoqëror vetëm shqiptar, kurse gjuha e dytë përkatëse si gjuhë e punës dhe më përdorime në të gjitha funksionet kryesore.

Gjatë hartimit të këtij punimi janë intervistuar persona që i takojnë kryesisht dialektit gegë dhe i përkasin *moshave prej 2 deri në 50 vjet, të të dy gjinive*. Subjektet jetojnë në: *Amerikë, Angli, Zvicër e Gjermani*.

*Dallimet që dalin te fëmijet janë në rrafshin gjuhësor, më shumë në ndërtimin e fjalive, kurse tek të rriturit ka pasur më shumë dallime në leksik.*

# KAPITULLI I PARË

## ÇËSHTJE TË DYGJUHËSISË DHE SHUMËGJUHËSISË

Kërkimet sociolinguistike më kryesore rreth *gjuhëve në kontakt* janë bërë nga autorë të autoritetshëm të sociolinguistikës së sotme, si *Uirel Uajrajh* (1953:1954), *Ferguson* (1959). Më 1953 Uajrajhu u kushtoi një punim të gjerë problemeve të gjuhëve në kontakt, duke prekur aty raste të ndryshme të bashkëekzistencës së gjuhëve në kontakt brenda një shteti të vetëm, si p.sh . rastin e gjermanishtes, frëngjishtes dhe të italishtes në Zvicër; ai përcaktoi, gjithashtu, se ndërveprimi (interferenca) i ndërsjelltë i gjuhëve në kontakt përcaktohet nga faktorë strukturorë dhe jashtëgjuhësorë<sup>1</sup>.

### 1. Ç'është dygjuhësia apo bilinguizmi ?

Me **dygjuhësi** (bilinguizëm) duhet kuptuar aftësia për të përdorur dy gjuhë njëkohësisht<sup>2</sup>.

Situatë e dygjuhësisë është atëherë kur njeriu mund të shërbehet rrjedhshëm, sipas situatave të jetës së tij të përditshme, nga dy gjuhë për të komunikuar me të tjerët dhe kur këtë komunikim dygjuhësor e pranojnë si mjedisi ashtu edhe situata e përgjithshme sociolinguistike<sup>3</sup>.

Kur është fjala për individë apo grupe individësh që zotërojnë dy a më shumë gjuhë kemi të bëjmë me **dygjuhësi individuale**. Në këtë rast njëra nga gjuhët është gjuhë amtare e folësit, kurse tjetra dytësore, e mësuar nga individi si gjuhë e huaj. Kjo lloj dygjuhësie, që haset në çdo shoqëri, është tipike sidomos për mergimtarët e brezave të parë, për popullsitë e zonave kufitare dhe për shoqërinë moderne<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup> Shih: Gj.Shkurtaj, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009, fq.277

<sup>2</sup> Shih: R.Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Toena, Tiranë, 2008, f.297

<sup>3</sup> Shih. Gj. Shkurtaj, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009, f.282

<sup>4</sup> Shih. R.Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Toena, Tiranë, 2008, f.297

## 2. Ç'është shumëgjuhësia apo multilinguizmi?

Ekzistojnë shumë shtete që për arsye të ndryshme si *ekonomike, politike, fetare, çështja e emigracionit* etj., të jenë dy- dhe shumëgjuhëse; lindja e dy- dhe shumëgjuhësisë ndodh për shkak të kontakteve gjuhësore që kanë shtete të ndryshme me njëra-tjetrën.

Kur ndodh që numri i gjuhëve që fliten të jetë më shumë se dy, kemi të bëjmë me **dukurinë e shumëgjuhësisë**. Parë në planin e shtrirjes horizontale kemi bashkësi dy- dhe shumëgjuhëse. Në këtë rast, të gjitha gjuhët që përdoren kanë shtrirje dhe status të njëjtë, si p.sh. Kanadaja ku anglishtja dhe frëngjishtja janë gjuhë kombëtare. Një situatë tjetër është ajo e vendeve dy- ose shumëgjuhëse me gjuhë që kanë status të njëjtë, por shtrirje të ndryshme, si p.sh. Zvicra, ku gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja janë të tria gjuhë zyrtare, por popullsia e kantonizuar sipas gjuhëve është kryesisht njëgjuhëse. Në të gjitha këto raste kemi të bëjmë me **dygjuhësi kolektive**. Karakteristikë e kësaj dygjuhësie është se të dyja gjuhët janë amtare<sup>5</sup>.

## 3. Dallimi bilinguizëm- plurilinguizëm- multilinguizëm

**Bilinguizmi** është aftësia për të përdorur dy kode të ndryshme gjuhësore në rrethana e situata të ndryshme të jetës së përditshme;

**Plurilinguizmi** është pronë e individit. Për individë të caktuar themi se janë *plurilingualë* ose “poliglotë”, duke e kuptuar plurilinguizmi si aftësi për të përdorur gjuhë të ndryshme për qëllime komunikative dhe për të marrë pjesë në ndërveprimin interkulturore, duke disponuar jo vetëm një, por disa tipe të ndryshme kompetencash në shumë gjuhë dhe duke pasur përvojë apo njohje të shumë kulturave<sup>6</sup> ;

**Multilinguizmi** është “pronë” e një territori. Vend, krahinë a shtet *multiling*, sepse ka me shumë se një gjuhë dhe patjetër , jo vetëm një, por disa ose shumë varietete gjuhësore që përdoren në mënyrë konkurrionale brenda një bashkësie<sup>7</sup>.

---

<sup>5</sup> Shih. R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Toena, Tiranë, 2008, f.297

<sup>6</sup> Shih. Gj. Shkurtaç, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009, f.180

<sup>7</sup> Shih. Po aty, f. 180

#### 4. Dallimi dygjuhësi- diglosi

Pra, *dygjuhësi* është aftësia për të përdorur dy gjuhë të ndryshme njëkohësisht ndërsa me *diglosi* kemi një situatë gjuhësore ku përveç dialekteve parësore ekziston një varietet i mbivendosur që përdoret në situata të komunikimeve formale dhe publike ndërsa varieteti tjetër përdoret nga të gjithë në të folmet e përditshme dhe në rrethana normale.

Dy varietetet normalisht emërtohen si varieteti i “lartë” (L) dhe i “ulët” (U) ose “standard” dhe “e folme”<sup>8</sup>.

Një shembull në gjuhën shqipe për diglosi e kemi gjuhën *standarde dhe dialektin*.

Ferguson ka shpjeguar qartë se situata tipike të *diglosisë* gjejmë kryesisht në vendet ish-koloniale, ku një gjuhë vendase ndeshet me një gjuhë të zhvilluar të kolonialistëve evropianë, p.sh në Haiti. Atje, bashkekzistenca e gjuhës së përditshme dhe e varieteteve të mbivëna me prestigj zyrtar, bën që brenda së njëjtës bashkësi folëse, herë të përdoret njëri e herë tjetri varietet<sup>9</sup>.

Kur kodet gjuhësore që përdoren paralelisht në një bashkësi homogjene dy-shumëgjuhëse nuk kanë status të njëjtë social, kemi një situatë tjetër që njihet me emrin *diglosi*. Një situatë tipike të diglosisë është ajo që haset në vendet arabe, ku arabishtja klasike shërben si një kod i lartë që përdoret si gjuhë e fesë, në edukim dhe në veprimtari të tjera intelektuale, kurse arabishtja popullore si një kod i ulët që shërben për komunikimin e përditshëm<sup>10</sup>.

#### 5. Shkaqet e kontakteve mes gjuhëve dhe lingua franka

Lëvizjet e mëdha për shkaqe të ndryshme *ekonomike, politike, fetare* etj. Kanë bërë që brenda një territori të jetojnë popullsi që flasin gjuhë të ndryshme. Këto kontakte midis bartësve të gjuhëve të ndryshme lënë gjurmë edhe në gjuhët e tyre. Në të gjitha rastet e pranishme së

---

<sup>8</sup> Shih. R. Hudson, Sociolinguistika, Dituria, 2002, f.60

<sup>9</sup> Shih. Gj. Shkurtaç, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009, f.281

<sup>10</sup> Shih. R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Toena, Tiranë, 2008, f. 297



njëkohshme të kodeve të ndryshme gjuhësore brenda të njëjtit territor ose brenda së njëjtës bashkësi gjuhësore themi se kemi të bëjmë me **kontaktet gjuhësore**<sup>11</sup>.

Kur të shpërngulurit europianë ranë në kontakt me popuj të kontinenteve të tjera apo kur udhëtarë, tregtarë, fetarë me gjuhë të ndryshme u përfshinë në veprimtari jetësore të përbashkëta, nevoja për të komunikuar u përmbush me rrugë të ndryshme; në disa raste, ardhësit mësuuan gjuhën e vendasëve ose, e kundërta. Gjuhët që përdoren për komunikim ndërmjet folësve prej vendesh me gjuhë të ndryshme, quhen **lingua franka**. Lingua franka bëhet ose një nga gjuhët që kanë më shumë prestigj në rajon, ose një nga gjuhët që krijohen në mënyrë të pavetëdijshme për të mundësuar komunikimin<sup>12</sup>.

## 6. Dygjuhësia e emigracionit dhe faktorët socialë

Ky lloj dygjuhësie karakterizohet nga fakti se fëmija duhet të përballojë jashtë mjedisit familjar, përgjithësisht *njëgjuhës* (monoling) një gjuhë të ndryshme, që nuk e flasin medoemos prindërit e tij ose që e flasin keq. Ky tip i dygjuhësisë ka prirje të zhvillohet e të përhapet shumë aktualisht në vendet e pasura si pasojë e dyndjes së punëtoreve të krahut nga viset e huaja<sup>13</sup>.

Njerëzit për interesa ekonomike, të punës, janë detyruar të mësojnë gjuhë apo kode gjuhësore për të siguruar pjesëmarrjen në shoqërinë p.sh: emigrantët tanë në Gjermani mësojnë gjermanishten, ata që ndodhen në Angli mësojnë anglishten, ata që jetojnë në Francë mësojnë frëngjishten etj. Arbëreshët iu nënshtruan trysnisë së vazhdueshme të italishtes, shqiptarët e Bullgarisë, gjuhës bullgare, shqiptarët e Ukrainës gjuhës ukrainase, shqiptarët e Zarës gjuhës kroate, por me gjithë deformimet që pësoi shqipja, arriti të mbijetojë<sup>14</sup>.

Po ashtu edhe subjektet që i kemi pasur për studim pothuajse të gjithë kanë qënë bashkëatdhetarë tanë që në kohën e luftës kanë emigruar në vendet e huaja, më së shumti për arsye ekonomike. Së pari ata janë detyruar që të jetojnë në situata dygjuhësie tani edhe fëmijët e tyre janë të detyruar që përveç gjuhës native ta mësojnë edhe gjuhën e dytë përkatëse.

<sup>11</sup> Shih. R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Toena, Tiranë, 2003 f. 296

<sup>12</sup> Shih. po aty, f.298

<sup>13</sup> Shih. Gj. Shkurtaç, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009, f.291

<sup>14</sup> Shih. F. Dulaj, E folmja e Rahovecit me rrethinë, Prishtinë, 2016, f.284

## 7. Dygjuhësia tek te folmet e arbëreshëve të Italisë

Gjuha shqipe që flasin *arbëreshët e Italisë* paraqitet si një formë në vete. Po të vështrojmë elementet sturkturore dhe fonetike themelore të ligjërimeve arbëreshe, rezulton se ato i përkasin toskerishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të çamerishtes e të laberishtes, po edhe me gjuhën e autorëve të vjetër gegë<sup>15</sup>.

Takimi i të folmeve arbëreshe me italishten pas shpërnguljes nga Shqipëria, u bë në rrethana krejt të tjera, të cilat me kohë sollën edhe *dygjuhësinë arbëresho-italiane*. Është me rëndësi të theksojmë se rrallë gjen tek arbëreshët një dygjuhësi te përsosur, çka tregon se atje arbërishtja ka mbajtur kurdoherë vendin e gjuhës së parë (L1), ndërsa italishtja ka mbetur gjuhë e dytë (L2)<sup>16</sup>.

## 8. Përzirja e kodeve gjuhësore

Kur një biling i zhdervjellët, duke folur me një biling tjetër të zhdervjellët, ndryshon gjuhën pa u vënë re ndonjë ndryshim në situatë, e quajmë **përzirje kodesh**<sup>17</sup>.

Nuk ekzistojnë shumë hulumtime lidhur me çështje të *përzirjeve së kodeve gjuhësore*. Ai që është marrë me përzirjen e kodeve gjuhësore studiuesi zviceran *Bazil Shader* që bëri një studim doktorati rreth takimit të gjermanishtes në Zvicër me gjuhën shqipe.

Shaderi thekson se kod-suiçingu shqip-gjermanisht, edhe pse tepër i përhapur në Zvicrën gjermanishtfolëse ende s'është bërë objekt i hulumtimeve shkencore. Ai del si kod-suiçing i përditshëm. Në të llogariten, ndër të tjera, insercionet (ndërfutjet) e thjeshta të shumta që gjenden në fjali me sturkturë bazale të qartë. Tipi i dytë më i zhvilluar dhe me kompleksitet gjuhësor më të lartë, përfshin *kod-suiçingun* demonstrues, grupo-indentitar. Arsyja e kompleksitetit më të lartë të tij është, së pari, kompetenca dygjuhësore më e lartë e folësve që e praktikojnë atë, dhe, së dyti, funksionaliteti i ndryshuar, duke qënë se në atë variant, mënyra dygjuhësore e të folurit nuk shërben thjesht si mjet ndihmës për të bërë më ekonomik

<sup>15</sup> Shih. J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, Dialektologji, Tiranë, 2003, f. 275

<sup>16</sup> Shih. Po aty, f. 281, 288

<sup>17</sup> Shih. R. Hudson, Sociolinguistika, Dituria, 2002, f.65

komunikimin, por si mjet përmes të cilit folësi mund ta shprehë në mënyrë ekspresive indentitetin dygjuhësor dhe dykulturore të tij<sup>18</sup>.

Shembuj të gjermanishtfolësve shqiptarë, që jetojnë në Zvicër, që i kemi hasur gjatë hulumtimeve tona janë:

*Shpesh nuk ka ven n'park pllac.*

*Dy vjet i ka bo për valentin stag.*

*A po bojm gemyze me soze?*

*N'spital nuk punojn shum nacionala.; etj.*

---

<sup>18</sup>Shih. Gj. Shkurtaç, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009, f.325

## KAPITULLI I DYTË

### 1. Ndikimi fonetik i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë

#### Theksi

Ligjërimi ynë në aspektin tingullor përbëhet nga njësi segmentore ose vijore, d.m.th nga tinguj, rrokje, fjalë dhe njësi mbisegmentore jovicore, ku bëjnë pjesë sidomos theksat e ndryshëm dhe intonacioni. Mjetet që shërbejnë për të nxjerr në pah një rrokje të fjalës në krahasim me të tjerat, janë të ndryshme për gjuhë të veçanta. Prandaj theksin zakonisht e përkufizojmë si **të spikaturit e një rrokjeje me mjete të ndryshme fonetike**<sup>19</sup>.

Subjektet që i kemi pasur për hulumtimin i takojnë moshave të ndryshme dhe dallimet që i kemi vërejtur në fontikë kanë qënë kryesisht të theksimi i fjalëve më të moshuarit e bëjnë përdorimin e fjalës së huaj sipas theksit të gjuhës shqipe d.m.th e shqipërojnë fjalën përkatëse p.sh: *//e kom bo fill fentragen(kontraten) e punes//, // ku i kini gishetat(dhuratat)//, // kur kam hi për leje t'kerrit kam duft me shku n'gemenie me marr formularin// etj.* Këto fjalë sipas theksimit apo shqiptimit na dalin si fjalë të gjuhës shqipe.

Ndërsa të rinjtë përdorimin e fjalës së huaj e bëjnë sipas theksit të gjuhës së huaj p.sh: *//nein përshka//, // Lind a don me lujt fusball// // te na jepin kindegel//, // happy birthday bab//, //Mali qafe the baby//, // Mali do you wanna go te Valoni me lujt ball//, // who you ardh me?// etj.*

**Shënim:** Kryesisht tek të rinjtë që jetojnë në Angli kemi parë së ngjyresa e zërit gjatë të folurit në gjuhës shqipe del si ngjyresë zëri e anglishtes. Po ashtu edhe te ata që jetojnë në Gjermani kanë theks të gjermanishtes ose ata që jetojnë në Francë kanë theks të frëngjishtës.

---

<sup>19</sup> Shih. A. Dodi, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, f.157

## 2. Ndikimi morfologjik i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë

### 1.1 Emri

Siç e dimë emri në gjuhën shqipe ndryshon sipas numrit, gjinisë, rasës e trajtes. Gjatë hulumtimeve tona të bashkëatdhetaret tanë kemi vërejtur disa ndryshime morfologjike te përdorimi i trajtave të emrave gjatë të folurit. Tek gjermanishtfolësit kemi vërejtur se përdorimin e emrave e bëjnë sipas gjedhes së gjuhës shqipe p.sh; // *n'spital nuk punojnë shumë nacionala*// emri nacionala (në standard ndërkombëtar) del si emër i gjinisë femërore në numrin shumës, del në rasën emërore po ashtu në trajtën e shquar. Një shembull tjetër kemi // *hala s'ma kan nshu aufentallin*// këtu kemi emrin aufentallin (në standard lejeqëndrimin) që na del si emër i gjinisë mashkullore, i shquar, në numrin njëjës dhe në rasën kallëzore. Pastaj të një shembull tjetër kemi // *kush e ka gebustakin*//edhe këtu kemi emrin gebustakin (në standard ditëlindjen) që i përshtatët trajtës së gjuhës shqipe del si emër i gjinisë mashkullore, trajta e shquar, numri njëjës, dhe në rasën kallëzore.

Një dukuri mjaft interesante del edhe përdorimi i emrave **baushtell**, **shacat**, **renti**, **ausllandera**, **fans**, që përdoren edhe nga shqipfolësit që jetojnë në Kosovë. Këta të fundit të ndikuar nga bilinguistët shqiptarë që jetojnë atje po vazhdojnë t'i përdorin ato sikur të ishin fjalë shqipe. Kemi dëgjuar shpeshherë sidomos gjatë sezonës së verës shqipfolësit të thonë: // *erdhen shacat*//, // *punoj n'baushtell në vend të punoj në ndërtimtari*//, po ashtu edhe përdorimin, në disa raste ironie të fjalës **ausllander** // *ahh ti ausllander je*//. Po ashtu në leksikun e gjuhës shqipe gjithnjë e më shumë po përdoret fjala **rent** nga anglishtja (në standard- qira, qiraja) si tek të rriturit ashtu edhe tek fëmijët p.sh:// *po e marrim ni kerr me rent-renta*//.

Shqiptari që punon në Gjermani, në Austri, në Zvicër dhe në ndonjë vend tjetër gjermanishtfolës, veten e tij e quan, atje dhe këtu, jo më me fjalë të dhembshme të shqipes i huaj, i mërguar, por me fjalën gjermane *auslander* (gjerm. Auslander “i huaj, jövendës”, Ausland

“bota e jashtne”), ndërsa vetë gjermanin e quan po kështu me një fjalë jo të shqipes *shfabë*, e gjermanen *shfabricë* (gjerm. Schvvaben)<sup>20</sup>.

## 1.2 Mbiemri

Mbiemër quhet ajo pjesë e ligjeratës që emërton një tipar, cilësi, veti a marrëdhënie të sendit dhe përshtatet në gjini, numër e, për një pjesë, edhe në rasë me emrin e këtij sendi<sup>21</sup>. Siç e dimë në gjuhën shqipe mbiemri zakonisht vendoset pas emrit, mirëpo gjatë hulumtimeve tona kemi vërejtur se në disa raste bashkëatdhetarët tanë e vendosin mbiemrin përpara emrit p.sh: // *ka qef me ngu shllagen muzik*// këtu mbiemri na del *shllagen muzik* ( në standard muzik popullore) d.m.th nga ndikimi i gjuhës gjermane del i vendosur para emrit.

Mirëpo një shembull tjetër nga gjuha angleze del // *i kom dokumentat british*// këtu kemi mbiemrin *british* (në standard britaneze), del i vendosur pas emrit dhe përshtatet sipas trajtës së gjuhës shqipe.

## 1.3 Përemri

Përemri është pjesë e ndryshueshme e ligjeratës.

Përemri kuptimin konkret e merr në kontekst, në kushtet e ligjërimit të lidhur<sup>22</sup>. Në hulumtimet tona edhe përemri na dal po ashtu sipas modelit a gjedhes së gjuhës së huaj përkatëse. Tek anglishtfolësit zakonisht të moshës 2-6 vjeç kemi vërejtur se përdorim e *përemrit vetor* e bëjnë sipas modelit të anglishtes. Përemri i vetës së parë shumës **ne**, të bashkëatdhetarët, na delsi trajtë dialektore në rasën kallëzore **na**. P.sh: // *Flor hajde me na*// . Fëmijët e bëjnë përkthimin e fjalisë ashtu siç është në gjuhën angleze p.sh: // *Flor come with us*//.

Po ashtu tek fëmijët kemi vërejtur se përkthimin e bëjnë fjalë për fjalë pasi që edhe *përemri pyetës* del po ashtu sipas modelit të gjuhës angleze p.sh:// *me kush don me flejt Jetë*//, tek ky shembull përdorimi i përemrit pyetës *kush* bëhet në vend të përemrit *me kë*, edhe kjo rrjedh nga ndikimi i anglishtes p.sh// *with who do you want to sleep Jetë*//.

<sup>20</sup> Shih. Q. Murati, Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes, f.287

<sup>21</sup> Shih. ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f.153

<sup>22</sup> Shih. po aty, f.215

## 1.4 Parafjala

Duke pasur parasysh se parafjala në gjuhën shqipe sipas rregullave gramatikore nuk vendoset kurrë në fund të fjalisë, te subjektet anglishtfolës kryesisht fëmijë, gjatë të folurit parafjala gjithomë del në fund të fjalisë p.sh:// *qka osht kjo për/ – what is this for?//, //kush u martu me (në standard- me kë është martuar)? – who got married with?// etj.*

### 3. Ndikimi sintaksor i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë

#### 1.1 Rendi i fjalisë

Në gjuhën shqipe rendi i gjymtyrëve është relativisht i lirë, rendi më i zakonshëm është *kryefjalë + kallëzues + kundrinë + rrethanor*<sup>23</sup>. Duke ditur se *gjuha angleze ka rend të ngulitur të fjalisë*, atëherë edhe shqipfolësit bilingual të anglishtes që jetojnë në Amerikë gjatë të folurit u janë përshtatur rendit të gjuhës shqipe duke lënë që kryefjala të jetë e nënkuptuar p.sh: // *krejzi osht a! - he's crazy!* //

#### 1.2 Fjalitë dëftore

Fjalitë dëftore quhen fjalitë që kumtojnë zakonisht fakte të realitetit<sup>24</sup>. Te subjektet që i kem pasur në studim ka pasur mjaft fjali dëftore dhe përdorimin e tyre e kanë bërë sipas natyrës së gjuhës shqipe p.sh: // *ni njerit që rrin n'banhof ja jepi qizmet* //, // *duhet m'i bo me shllagzane* // etj.

#### 1.3 Fjalitë pyetëse

Gjatë hulumtimeve tona kemi vërejtur se shqiptarët e diasporës në disa raste përdorimin e fjalitë pyetëse e kanë bërë sipas natyrës së gjuhëve me të cilat janë në kontakt. Rendi i fjalitë pyetëse sipas natyrës së gjuhës së huaj është vërejtur më shumë të fëmijët.

Përderisa në gjuhën shqipe përemrat e ndajfoljet vihen zakonisht në krye të fjalitë po jo gjithmonë, kurse pjesëzat mund të vihen në krye, në mes a në fund<sup>25</sup>, te subjektet gjatë hulumtimit përemri pyetës të fjalitë pyetëse del po ashtu në fillim p.sh: // ***cilin** man e ka*

---

<sup>23</sup> Shih. Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 2, ASHSH, Tiranë, 2002, f. 125

<sup>24</sup> Shih, po aty, f.122

<sup>25</sup> Shih, po aty, f. 139



*nusja?//, //ku i keni gishetat?//* etj, ndërsa pjesëza del në fillim, e në mes p.sh: *// a je tajred//, // prit aba a po ma merr beben?//.*

Parafjalët në fjalinë pyetëse në gjuhën shqipe vendosen para emrave pyetës p.sh *// te kush është ajo?//, //më kë do të flesh, Jetë?//, // për çka është kjo?//, //me kë është martuar?//, por gjatë hulumtimit kemi vërejtur që këto dalin sipas natyrës së gjuhës së huaj, përkatësisht të gjuhës angleze. Dalin në fund të fjalisë pyetëse, p.sh: *//ku o ajo te?//, // çka osht kjo për?//, //kush u martu me?//.**

Fjalia pyetëse që ndërtohet për të pyetur për sasi në gjuhët e huaja me shprehjet përkatëse p.sh: *many, much* etj, bilinguistët shqiptarë i përdorin këto shprehje po ashtu në ndërtimin e fjalisë pyetëse p.sh: *//sa shumë vjet i ki?//, //sa shum sheqer ki qit?//*, ndërsa në gjuhën shqipe tingëllojnë sikur fjali habitore.

#### 1.4 Fjalja dëshirore

Fjali dëshirore janë fjalitë që shprehin vullnetin e folësit, në formë dëshire ose kërkesë, për realizimin e mosrealizimin e një veprimi, të një gjendjeje<sup>26</sup>. Te subjektet gjatë hulumtimit kemi vërejtur edhe përdorimin e fjalive dëshirore sipas natyrës së gjuhës së huaj p.sh:*//jeto gjatë bab//*, këtu folja nuk është përdorur në mënyrë dëshirore por në mënyrë urdhërore nga ndikimi i gjuhës angleze, pasi që anglishtja nuk e ka mënyrën dëshirore të foljes p.sh: *// live long dad//.*

Ndikimi i anglishtës po vërehet edhe të shqipfolësit e rinj dhe të moshuar të Kosovës të cilët në vend të foljes *// kalofsh mirë//* përdorin mënyrën urdhërore *// kalo mirë//.*

---

<sup>26</sup> Shih. Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 2, ASHSH, Tiranë, 2002, f.129

#### **4. Përbërja leksikore në raste të dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë**

Tërësia e fjalëve të një gjuhë përbën **leksikun** e asaj gjuhe.

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Është vërtetuar tashmë përfundimisht që ajo përbën një degë të veçantë të familjes gjuhësore indoeuropiane, por, siç shkruan Eqrem Çabej, nuk ka lidhje “birërie” me asnjë nga gjuhët e kësaj familje, me gjithë afrinë në sistemin gramatikor e në leksik; ajo ka me ato lidhje “motërie”<sup>27</sup>.

Gjatë hulumtimeve tona erdhëm në përfundim se ndikimi i gjermanishës i takon më shumë sferës leksikore.

Fjalët më të zakonshme të *gjuhës gjermane* që i kanë përdorur bilinguistët shqiptarë në vend të *gjuhës shqipe* janë këto :

**Shtrasenbau- rrugë**

**Banhof- stacion**

**Tankshell- pumpë e benzinit**

**Aufentall- lejeqëndrim**

**Autoban- autostradë**

**Aullandera- të huaj**

**Gemenie- komunë**

**Eksperti- instruktori**

**Shtojeri- tatimi**

**Apotek- barnatore**

**Zaft- shurup etj.**

---

<sup>27</sup> Shih. J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Toena, Tiranë, f. 245

## Materiale

**Habemeni** mjekja për fmi që vjen n'shpi pas lindjes.

Duhet mi bo me **shllagzane**.

Për fmi që kan pas ndonjë **hendikep**.

Nuk e kemi marrë asnjë **bitbek** prej askuj.

Ama **kendin**.

A don me hi **n'pull**?

Gjuje **n'gabiq**.

Punon **n'tankshtell**.

I ka ble do si **shtrudlle**.

Unë i ha me **fruten** t'detit.

**Eksperti** që t'mson me vozit.

N'psikiatri punojn ma shum **ausllandera**.

**Renti** me pagu n'Angli osht shum shtrejt.

Duhet m'i plotsu **beverbungat** kur t'lyp me punu.

Veç isha shku dej **n'apotek** e kisha marr ni **zaft** për temperatur.

Rrike si **drraj** qatje.

Kur po jon fmija n'pushim po jon **buletat** shum shtrejt.

Nuk hajshim buk **n'kantin** po hajshim n'dhom.

Dyt shkojn **n'kidergarde** bashk etj.

## Përfundim

Nga tema e shqyrtuar dhe kërkimet e bëra në lidhje me këtë punim mund të themi se çështja e dygjuhësisë është mjaft e përhapur te shqiptarët që jetojnë në diasporë, si tek të rinjtë ashtu edhe tek më të moshuarit.

Pamë se shkaqët të cilat ndikojnë në përhapjen e gjuhës janë nga më të ndryshmet si ato: *ekonomike, sociale, politike dhe më kryesorja bashkëjetesa në situata dygjuhëse* që ndikon në përzirjen e kodeve gjuhësore të gjuhës shqipe dhe të gjuhës së huaj përkatëse.

Të rinjtë kanë marrë *ngjyresë zëri* sipas gjuhës së vendit ku jetojnë.

Më të moshuarit e bëjnë përdorimin e fjalës së gjuhës së huaj sipas natyrës së gjuhës shqipe duke e shqipëruar atë.

Të rinjtë e bëjnë përdorimin e gjuhës së huaj sipas natyrës së gjuhës së huaj përkatëse, dhe në këtë mënyrë bëjnë përzirjen e kodeve gjuhësore siç pamë në mjaft shembuj të cekur më lart.

Erdhëm në përfundim së ndikimi i anglishes është më i përhapur në disa fusha gjuhësore si në: fonetikë, morfologji, sintaksë e në leksik, kurse ndikimi i gjermanishtes është më i përhapur kryesisht në leksik.

**Rekomandim:** Në fund mund të themi se çështja e gjuhës shqipe te bashkëatdhetarët që jetojnë jashtë Kosovës është mjaft shqetësuese. Së pari sugjeroj që prindërit shqiptarë të ndikojnë më shumë te fëmijët e tyre në përvetësimin e gjuhës shqipe. Dhe së dyti qeveritë shqiptare, ajo e Kosovës dhe e Shqipërisë, duhet të investojnë më shumë në ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe kudo në diasporë, përmes organizimit të mësimin plotësues atje.

## **Literatura**

- I. Shkurtaç, Gjovalin, Sociolinguistikë e shqipes, Morava, Tiranë, 2009**
- II. Memushaj, Rami, Hyrje në gjuhësi, Toena, Tiranë, 2008**
- III. Dulaj, Fridrik, E folmja e Rahovecit me rrethinë, IAP, Prishtinë, 2016**
- IV. Hudson, Richard, Sociolinguistika, Dituria, Tiranë, 2002**
- V. Gjinari, Jorgji, Shkurtaç, Gjovalin, Dialektologjia, Tiranë, 2003**
- VI. Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 1, ASHSH, Tiranë, 2002**
- VII. Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 2, ASHSH, Tiranë, 2002**
- VIII. Dodi, Anastas, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, ASHSH, Tiranë, 2004**
- IX. Thomai, Jani, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Toena, Tiranë**
- X. Murati, Qemal, Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes, IAP, Prishtinë, 2004**